



**Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues**

**AKDIE**

**ASAMBLEJA E ARTISTËVE**

---

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 14, hyrja 259 Site : [www.akdie.org](http://www.akdie.org) ; email: [a.k.d.i.e.albania@gmail.com](mailto:a.k.d.i.e.albania@gmail.com)

**RAPORT**

**I AKTIVITETIT TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV AKDIE**

**PËR VITIN KALENDARIK 2021**

Më datë 28.12.2021, me kërkesën e Presidentit të Agjencisë AKDIE, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Agjencisë AKDIE

**Bazuar :**

- në ligjin nr. 35/2016 „Për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të“
- në ligjin nr. **8788, datë 7.5.2001 PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE**, nenet 10 dhe 21,
- në Statutin e Agjencisë AKDIE

**VENDOSI**

A-Miratimin e veprimtarisë administrative të agjencisë „AKDIE“, për vitin 2021, duke e konsideruar atë, në përputhje me interesin më të mirë të Agjencisë AKDIE, të komunitetit të artistëve dhe në përputhje të plotë me ligjin dhe me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Agjencisë AKDIE.

B- Miratimin e aktivitetit financiar të kryer përgjatë vitit 2021 të Agjencisë AKDIE duke konkluduar se, në kushtet kur bazuar në **Ligjin nr 35/2016, neni 138 i tij, arkëtimi i të ardhurave nuk kryhet nga AKDIE por nga SUADA dhe cdo rezultat financiar i aktivitetit të AKDIE është i kushtëzuar nga sukcesi apo mosesuksesi i SUADA dhe agjencisë drejtuese të saj, e cila është vendosur nga ana e KKDA**, ka qënë e detyrueshme kalimi i pragut për shpenzimet administrative, pasi janë paguar detyrimet e prapambetura karshi të tretëve edhe për vitin 2020, vit i cili për shkak të shtuar edhe të pandemisë ishte me një rezultat financiar katastrofik. Sipas kontrollit financiar të kryer, mbi të gjithë zërat e shpenzimeve, nga ku doli se

shpenzimet e kryera, kanë qënë në dobi të agjencisë dhe në përputhje me qëllimin e agjencisë, legjislacionin në fuqi dhe vecanarisht me atë tatimor,.

- 1- Janë ruajtur me korrektësi përmbushja e të gjitha detyrimeve tatimore. **(+15%TB si dhe shpenzimet e tjera si sigurimet shoqerore dhe shendetesore, taksa bashkiake etj)**
- 2- Ekzekutimin e Vendimit nr. 1 datë 18.12.2020 dhe Vendimit nr. 1 datë 13.02.2021 të Këshillit Ekzekutiv, **të miratuar online nga anëtarësia**, që gjithësesi, do të konsiderohet, sipas nenit 15, pika 3 e Statutit të AKDIE, i cituar: - *“3. Në rastet e vecanta, (forca madhore, apo rastet e falimentimit, likuidimit, humbjes së interesit, dështimit të agjencisë, e të tjera si këto rrethana të jashtëzakonshme) kur numri i Asamblesë së Artistëve është i njëjtë me numrin e Këshillit Ekzekutiv, vendimi i Këshillit Ekzekutiv, në atë mbledhje, konsiderohet edhe Vendim i Asamblesë së Përgjithshme.”*- **për faktin se, në llogarinë bankare të Agjencisë AKDIE, pritet të hyjë shuma e transferuar nga SUADA, prej 9 2 000 000 lekë (nëntë milionë e dyqind mijë lekë).**
- 3- Veprimtaria është në përputhje me interesin më të mirë të saj, nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv Z. Naim ALIAJ, për shpëtimin e agjencisë në kohë pandemie, duke ofruar të gjitha shërbimet e saj, pavarësisht mungesës financiare të vitit 2020, me një të ardhur prej 1.6 milionë lekë vjetore dhe shndërrimin e pamundësisë financiare, në një sukses për shlyerjen e cdo detyrimi tatimor, ndaj të tretëve dhe një shpërblim dinjitoz për artistët, në shumën **12 milionë lekë të reja, në vitin 2021, por duke zbatuar edhe Vendimet e Asamblesë së Artistëve 2020 dhe Këshillit Ekzekutiv.**

#### **Në këto kushte, bazuar :**

1. Në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, sipas miratimit online, porse ligjërisht, është në formën e kërkuar nga neni 15, pika 3 e Statutit të AKDIE, Vendimet e Këshillit Ekzekutiv, nr. 1/2020 dhe nr. 1/2021.
2. Në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të”
3. Në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, nenet 10 dhe 21,
4. Në statutin e agjencisë AKDIE,
5. Udhëzimi i MK, nr. 663/2017,
6. Udhëzimi i MK, nr. 5166/2016, i ndryshuar nga Udhëzimi nr. 385/2020, i ndryshuar me Udhëzimin 472/2020, për shpenzimet e domosdoshme, për të përmbushur kriteret profesionale, për ekzistencën e një AAK,
7. Neni 605 i Kodit Civil, rradha e preferimit të përmbushjes së detyrimeve,

## KËSHILLI EKZEKUTIV DHE ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

### VENDOSI

1. Miratimi i veprimtarisë së Agjencisë AKDIE, si veprimtari në përputhje me interesin më të mirë të saj, nën drejtimin e Drejtorit Ekzekutiv Z. Naim ALIAJ, duke shprehur mbështetjen e anëtarësisë për të, në shpëtimin e agjencisë në kohë pandemie, duke ofruar të gjitha shërbimet e saj, pavarësisht mungesës financiare të vitit 2020, me një të ardhur prej 1.6 milionë lekë vjetore dhe shndërrimin e pamundësisë financiare, në një sukses për shlyerjen e cdo detyrimi tatimor, ndaj të tretëve dhe një shpërblim dinjitoz për artistët, në shumën **12 milionë lekë të reja, në vitin 2021.**
2. Miratimi i shpenzimeve, përfshirë tatimet, nën rezervën e raportit përfundimtar të Ekspertit Kontabël, për pasqyrën financiare, i gjetur në përputhje me interesin më të mirë dhe në dobi të agjencisë AKDIE, nga Këshilli i Auditit dhe në përmbushje të vendimeve të Këshillit Ekzekutiv, nr. 1/2020 dhe nr. 1/2021, të sipërcituar, nën parimin e shpenzimeve vjetore, “dysHEME 6 milionë lekë”, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Kulturës, nr. 5166/2016, i ndryshuar, për plotësimin e kriterëve profesionale të këtij udhëzimi, sipas përlogaritjes së ekspertit gjyqësor, në rastin objekt gjykimi, i cituar në vendimin e Këshillit Ekzekutiv, nr. 1/2020, në masë “dysHEME” 6 000 000 lekë (gjashtë milionë lekë), për cdo vit ushtrimor financiar.
3. Shuma e mbetur, për shpërndarje në masën **9 500 000 lekë (nëntë milionë e pesëqind mijë lekë), pasi 2 500 000 lekë (dy milionë e pesëqind mijë lekë)** u shpërndanë në fillim të vitit.
4. Për vitin 2021, shpenzimet e Agjencisë AKDIE, janë kryer në përputhje me nenin 151 të ligjit nr. 35/2016.
5. Vlera monetare e të hyrave në AKDIE, në vitin 2021 është 24 349 944 lekë, ku përfshihen edhe ato vlera, që priten të hyjnë nga SUADA, të cilat janë gjëndje në llogarinë bankare të SUADA, si pjesë takuese e AKDIE, nën rezervën e kontrollit të metejshëm të vlerës takuese. Kjo vlerë është përdorur për të ekzekutuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme së vitit 2020, sipas nenit 15/3 të Statutit, si dhe vendimin e Këshillit Ekzekutiv, nr. 1/2021.
6. Detyrimet tatimore të Agjencisë AKDIE, janë përmbushur plotësisht në vlerën 1004420
7. Detyrime ndaj të tretëve të Agjencisë AKDIE janë përmbushur plotësisht, përfshirë këtu qiranë e selisë AKDIE edhe për vitet 2020 dhe 2021, si dhe kontratat e punës me stafin e AKDIE duke shlyer edhe detyrimet e prapambetura të vitit 2020 dhe ato të vitit 2021.
8. Shpenzime të tjera të kryera janë:

-Tarifa e Licensës të AKDIE-300 000 lekë

-Shpenzime për ëeb- 66000 lekë

-Shpenzime drita ujë-40000 lekë

-Shpenzime fiskalizimi-7290 lekë

Komisione dhe detyrime bankare-54882 leke

9. Do vazhdojë shpërndarja tek artistët shqiptarë dhe të huaj sipas kontratave të përfaqësimit reciprok në vlerën prej 9 500 000 lekë e cila duhet të mbyllet deri në Mars 2022, ndersa vlera prej 2500000 është shpërndarë përgjatë vitit, me qëllim që shuma totale e shpërndarjes për artistët të jetën në masën 12000000 lekë në përputhje me Urdherin dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjiithshme dhe Këshillit Ekzekutiv

#### **SUBJEKTET PËRDORUESE:**

a/ rezultojnë subjekte përdoruese rreth 80 000 subjekte

b/ kanë përmbushur detyrimin vetëm 160 subjekte ose 0.2 % e subjekteve

#### **TË DREJTAT TË ARKËTUESHME:**

a/e drejta e transmetimit të fonogramit/videogramit të regjistruar dhe në qarkullim tregtar

b/ e drejta e ritransmetimit kabllor

c/e drejta e komunikimit në publik të veprave të regjistruara paraprakisht në mbajtëse zëri dhe figure

#### **1. NUMRI I PLOTË I ARTISTËVE NË PËRDORIM DHE RAPORTI I ARTISTËVE TË SHPËRBLYER:**



a/ në total janë të përdorur dhe të shpërblyer 17 117 artistë nga të cilët 355 janë shqiptarë


b/1 331 artistë të shpërblyer nga veprat audiovizuale nga të cilët 117 janë shqiptarë

c/15786 artistë të shpërblyer nga veprat muzikore


d/5403 artistë janë artistë kryesorë të muzikës si këngëtarë

e/10383 artistë janë artistë dytësorë të muzikës si instrumentistë apo korrnistë





raporti  
artiste  
vendas dhe  
artiste te  
huaj



ANKONDE